



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:245535

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406507

AA.nr.588/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS -Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit R.K, nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Tatimit në Pronë, me pjesëmarrjen e palës së interesuar Komuna e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Bajram Dili nga Prishtina nga Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal A.nr.2606/2021, të datës 22.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit R.K, nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.2606/2021, i datës 22.04.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal A.nr.2606/2021, të datës 22.04.2022, ne piken I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R.K nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të “anulohet si i paligjshëm vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr.99/2021 i datës 09.08.2021 dhe ky vendim i anuluar të zëvendësohet me aktgjykim, të detyrohet Komuna e Prishtinës që në përputhje me paragrafin 3 të nenit 46 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ta lëshoj vërtetimin me shkrim për palën e dëmtuar me përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar me heshtje me datën 23.12.2019, e më të cilin akt administrativ është pranuar në tërësi kërkesa-ankesa me fuqinë e ligjit-ex lege e paditësit-tatimpaguesit R.K e datës 22.06.2016, me nr.010-07-155461, si dhe pala paditëse të udhëzohet në procedurë kontestimore për realizimin e dëmit të shkaktuar nga ekzekutimit i akteve administrative të paligjshme të anuluar nga Komuna e Prishtinës”. Ndërsa në piken II të dispozitivit mbetet në fuqi vendimi me nr.99/2021 i datës 09.08.2021 i Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve-Departamenti i Tatimit në Pronë. Kurse ne piken III të dispozitivit është vendosur qe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi R.K nga Prishtina i përfaqësuar nga zyra ligjore e shoqërisë Emporium sh.p.k, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që të aprovohet si e bazuar në tersi ankesa e paditësin R.K nga Prishtina dhe të anulohet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë dhe ky vendim i anuluar të zëvendësohet me aktgjykim me të cilin aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.K nga Prishtina dhe të anulohet vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr. 99/2021 i datës 09.08.2021, dhe ky vendim i anuluar të zëvendësohet me aktgjykim me të cilin detyrohet Komuna e Prishtinës që në përputhje me paragrafin 3 të neni 46 të LPPA-së, të lëshoj vërtetimin me shkrim për palën e dëmtuar me përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje me datën 23.12.2019 e me të cilin akt administrativ është pranuar në tersi kërkesa- ankesa me fuqinë e ligjit ex-legee paditësit- tatim paguesit R.K e datës 22.06.2016 me nr.010-07-155461. Pala paditëse udhëzohet në Procedurë Kontestimore për realizimin e dëmit të shkaktuar nga ekzekutimi i akteve administrative të paligjshme të anuluar të Komunës së Prishtinës.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar nr.99/2021 të datës 09.08.2021, e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Tatimit në Pronë, ka refuzuar precizimin dhe plotësimin e ankesës nr.113/2021 dhe kërkesën për rishikimin dhe rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit nr.44/2021 të tatimpaguesit R.K nga Komuna e Prishtinës, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të Departamentit të Tatimit në Pronë.

Paditësi me datë 31.08.2021 ka dorëzuar në gjykatë parashtresën e titulluar “Padi dhe njëkohësisht dhe alternativisht kërkesë-parashtresë e veçantë për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues në bazë të nenit 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative”. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se paditësi në gjykatë fillimisht ka regjistruar parashtresën-kërkesë për nxjerrjen e aktit sipas nenit 68 të LKA-së, duke e marr numrin e lëndës së vjetër A.nr.1898/16 (kur lënda ishte trajtuar herën e parë në gjykatë), me të cilën ka kërkuar që të “nxirret aktgjykim plotësues, ashtu që të shpallet absolutisht i pavlefshëm akti administrativ i Komunës së Prishtinës-Drejtorisë për Financa-Departamenti i DTP-vendimi me nr.010/07-155461 i dt.10.02.2020, të anulohet dhe të ndryshohet akti administrativ dhe akti plotësues i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr.99/2021 i dt.09.08.2021 dhe nr.44/2021 i dt.07.05.2021, të vërtetohet se ka ndodhur heshtja administrative me dt.22.01.2020 në organin komunal kompetent-Departamentin e Tatimit në Pronë DTP në Komunën e Prishtinë, të aprovohet si i bazuar precizimi dhe plotësimi i ankesës me nr.prot.113-1/2021 i dt.07.05.2021 i ankuesit/paditësit, të vërtetohet e konfirmohet kthimi në gjendjen e mëparshme

të çështjes përmes kthimit në fuqi të ish vendimit të mëparshëm të Komunës së Prishtinës-Drejtorisë së Financave-DTP, i cili ka qenë në fuqi nga viti 2005-2015, pasi që ai është miratuar në bazë të fuqisë ligjore-ex lege me datën 22.01.2020, pas heshtjes administrative të organit kompetent komunal-DTR, në përputhje e detyrim të dispozitave të nenit 100 të Ligjit nr.L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të obligohet e paditura Komuna e Prishtinës ZTP, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë zbatimin e vendimit të mëparshëm të Komunës së Prishtinës-Drejtorisë së Financave-Spektori i Tatimit në Pronë i cili ka qenë në fuqi në rastin e paditësit deri me 31.12.2015, ose që nga viti 2005-2015 të bëhet barazimi i gjendjes financiare, si dhe të kthehen të gjitha mjetet e paguara më tepër për të cilat është ngarkuar padrejtësisht nga Komuna e Prishtinës-Drejtorija e Financave-Spektorit i Tatimit në Pronë përgjatë viteve 2016-2021, ashtu që të bëhet rimbursimi i plotë për vitin 2021, duke u bazuar në lartësinë e tatimit në pronë sipas ish-vendimit të lartpërmendur që ishte në fuqi deri me datën 31.12.2015, ndërsa mjetet e tepruara përmes rimbursimit ti kthehet në llogarinë e tatimpaguesit R.K nga Prishtina. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë-parashtresës, ka vlerësuar se padia-parashtresa e paditësit ka të meta, është jo e plotë dhe është e pa qartë, pasi që nuk dihen arsyet se pse ngrihet padia-parashtresa, nuk dihet nëse parashtresa e datës 31.08.2021 është padi sipas neneve 26-30 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.03/L-202, përmes të cilës është iniciuar konflikti administrativ, nëse po ndaj cilit akt administrativ kontestues të paditurës Komuna e Prishtinës apo Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës është iniciuar është iniciuar kjo padi, nëse padia është ushtruar për shkak të heshtjes administrative paditësi është dashur ti paraqes gjykatës provat që dëshmojnë se i ka shterur të gjitha mjetet e ankesës në procedurë administrative tek e paditura, duke përfshirë kërkesën e përsëritur në afatin prej 7 ditësh apo të deklarohej paditësi nëse parashtresa e datës 31.08.2021 e dorëzuar në gjykatë është parashtresë për nxjerrjen e aktit administrativ siç parashihet me dispozitat e nenit 68 të LKA-së, nëse po paditësi është dashur të paraqes si dëshmi kërkesën e ushtruar tek e paditura në afatin prej 7 ditësh, siç parashihet me dispozitën e nenit 68 par.1 të LKA-së, nuk dihet se në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ apo nëse kërkohet nxjerrja e aktit administrativ i cili nuk është nxjerr në afatin e parashikuar, andaj me aktvendimin A.nr.1898/16 të datës 19.10.2021 paditësit i ka kthyer në plotësim parashtresën e datës 31.08.2021, duke e obliguar të njëjtin që në afat prej 8 ta plotësoj parashtresën sipas vendimit të gjykatës. Tutje paditësi në padi, në parashtresën e datës 29.10.2021, parashtresën e datës 21.04.2021, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjykatës i sqaroj se në këtë procedure gjyqësore të konfliktit administrativ, pas nxjerrjes se vendimit me nr. 99/2021 i datës 09.08.2021, paditësi në këtë procedurë gjyqësore ka atakuar këtë vendim si vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe në këtë rast si palë e paditur duhet të jetë vetëm Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ka theksuar se në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ gjykatës i propozoj që të merr aktgjykim sipas propozimit të bërë në parashtresat me të cilat është bërë precizimi i padisë, respektivisht parashtresën e datës 29.10.2021, si dhe parashtresës së dorëzuar me datë 21.04.2021, parashtresa këto me të cilat është bërë precizimi i parashtresës-padisë sipas vendimit të gjykatës. Ka shtuar se konsideron që vendimi i atakuar me padi me nr. 99/2021 i datës 09.08.2021 i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve është vendim i pa ligjshëm, ngase ankesa jone për nxjerrjen e një vendimi nga Ministria ka qenë heshtja administrative e organit komunal të tatimit në pronë nga data 23.12.2019 e deri me 31.03.2021. Sipas paditësit Komuna e Prishtinës është dashur që aktin/ankesën e paditësit ta miratoj në baze të heshtjes administrative. Sa i përket çështjes se padisë e cila e ka bazën në vitin 2016 dhe e cila në vitin 2019 është nxjerr një aktgjykim, me të cilën padia jone është miratuar në tërësi dhe çështja i është kthyer të paditurës në ri shqyrtim dhe ri vendosje. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimet e veta e ka arsyetuar aktgjykimin e vet. Palët ndërgjyqëse e kanë pranuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe asnjëra palë nuk ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Me këtë rast në këtë situatë aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë është bërë i formës së prerë. Duke u bazuar në nenin 65 të LKA-së Komuna e Prishtinës ka qenë e detyruar që brenda 30 ditësh të nxjerr

vendimin e ri administrativ, duke u bazuar në aktgjykimin e gjykatës dhe në detyrim të ligjit, të nenit 65 të LKA-së. Këtë veprim Komuna e Prishtinës nuk e ka bërë, pavarësisht se çdo javë zyrtaret tanë kanë qenë dhe e kanë kërkuar një vendim. Prandaj i propozoj gjykatës që në të drejtën dhe detyrimin e saj ligjor të zbatoj ligjin me përpikëri, kundër vendimit të kontestuar të paditurës Ministria e Financave, duke aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulohet si i pa ligjshëm vendimi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve me nr. 99/2021 i datës 09.08.2021, dhe që ky vendim të zëvendësohet me aktgjykim nga gjykata, me të cilin të detyrohet ish e paditura Komuna e Prishtinës, në përputhje me par. 3 të nenit 46 të LPPA-së që ta lëshoj vërtetimin me shkrim për palën e dëmtuar, me përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar me heshtje me datën 23.12.2019, e me të cilin akt administrativ është pranuar në tërësi kërkesa, respektivisht ankesa me fuqinë e ligjit, e paditësit R.K e datës 22.06.2016, me nr. 010-07-155461 dhe që pala paditëse të udhëzohet në procedure kontestimore për realizimin e dëmit të shkaktuar nga ekzekutimi i akteve të pa ligjshëm të anuluar të Komunës së Prishtinës.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura drejt i ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005 dhe Udhëzimi Administrativ MF nr.02/2019 për Procedurat Ankimore të Tatimit në Pronë, ku ka refuzuar precizimin dhe plotësimin e ankesës së paditësit nr.protokolli 113-1/2021 të datës 07.05.2021 dhe kërkesën për rishikimin dhe ri shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit me nr.44/2021 i datës 07.05.2021 të nxjerr po nga vet, ngase precizimi dhe plotësimi i ankesës nga ana e paditësit dhe kërkesa për rishikimin dhe ri shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit me nr.44/2021 i datës 07.05.2021, në fakt nuk i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me dispozitën e nenit 9, par.1 të UA MF nr.02/2019, ku shprehimisht është paraparë që *“1.Një ankesë konsiderohet e pranueshme për shqyrtim të mëtejme nëse plotëson këto kushte: 1.1. Nuk është përjashtuar nga Ligji; 1.2. Ankuesi ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative të parashikuara në Kapitullin VIII të Ligjit dhe beson në mënyrë të arsyeshme se të drejtat apo interesat e tij të ligjshme janë cenuar nga Komuna ose Ministria e Financave; 1.3. Është paraqitur brenda afatit të parashikuar në Kapitullin VIII të Ligjit; dhe 1.4. Është në përputhje me çfarëdo kushti tjetër të parashikuar shprehimisht në Ligj”*. Prandaj e paditura më të drejt, pasi ka bërë shqyrtimin paraprak të precizimit dhe plotësimit të ankesës së paditësit nr.protokolli 113-1/2021 të datës 07.05.2021 dhe të kërkesës së paditësit të datës 06.07.2021 për rishikimin dhe ri shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit me nr.44/2021 i datës 07.05.2021, sipas paragrafit 2 dhe 3 të nenit 9 të UA MF nr.02/2019, ka vendosur të refuzoj precizimin dhe plotësimin e ankesës së paditësit, së bashku me kërkesën për rishikimin dhe ri shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit me nr.44/2021 i datës 07.05.2021, pasi që nuk ka pasur kompetencë lëndore ti trajtoj të njëjtat, për arsyet e theksuara më lartë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ka bazë pretendimi i paditësit se në rastin konkret ka pasur heshtje administrative nga ana e Komunës së Prishtinës dhe se e njëjta nuk e kishte zbatuar aktgjykimin e kësaj gjykate A.nr.1898/16 të datës 04.11.2019, me të cilin rasti vendim ishte aprovuar kërkesëpadia e këtij paditësit, ishte anuluar vendimi me nr.10-07-155461 i datës 22.06.2016 i Bordit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave të Komunës së Prishtinës dhe lënda ishte kthyer në ri shqyrtim dhe rivendose, kjo sepse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se Komuna e Prishtinës, duke vepruar sipas aktgjykimit të gjykatës A.nr.1898/16 të datës 04.11.2019, me vendimin me nr.010-07-155461 të datës 10.02.2020, kishte vendosur në ri procedurë sipas ankesës së paditësit, e me të cilin vendim e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e kishte lënë në fuqi njësinë e objektit me nr..., me tatimpagues me nr..., R.K. Se nuk ka pasur heshtje administrative e tregon edhe fakti që paditësi, pikërisht ndaj këtij vendimi më pastaj ka ushtruar ankesë tek e paditura me datë 07.04.2021, e cila ankesë kishte rezultuar me nxjerrjen e vendimit me nr.44/2021 të datës 07.05.2021 nga e paditura, me të cilin është aprovuar ankesa e paditësit, është anuluar vendimi me nr.010-07-155461 i datës 10.02.2020 i Zyrës së Tatimit në Pronë dhe lënda ishte kthyer në ri shqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se Komuna e Prishtinës duke vepruar në ri procedurë sipas vendimit me nr.44/2021 të datës 07.05.2021 të nxjerr nga e paditura, me vendimin me nr.10-07-155461/1 të datës 10.06.2021, ka aprovuar ankesën paditësit si të bazuar, ka vendosur që njësia e objektit me nr.31959959, me tatimpagues me nr.91708040784 R.K është llogaritur me tatim në pronë për vitin tatimor 2016-2020, sipas tabelës 1-pronë komerciale-dyqan/njësia e objektit 31959959, të faqes 2 dhe 3 të vendimit nr.44/2021 të datës 07.05.2021 të marr nga Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në dispozitivin e II të vendimit ka vendosur që njësia e objektit me nr.31952699, me tatimpagues me nr.91708040784 R.K është llogaritur me tatim në pronë për vitin tatimor 2016-2020, sipas tabelës 2-pronë industriale-fabrikë/njësia e objektit 31952699 të faqes 2 e 3 të vendimit nr.44/2021 të datës 07.05.2021 të marr nga Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në dispozitivin e IV të vendimit ka vendosur që të rimbursohet detyrimi i paguar më tepër në kartelën financiare të tatimpaguesit me nr.91708040784 të R.K dhe interesi për detyrimin tatimor të paguar më tepër, të llogaritet nga data e pagesës së detyrimit tatimor deri në datën e rimbursimit, si dhe në dispozitivin V është vendosur që të obligohen zyrtaret përgjegjës të Zyrës së Tatimit në Pronë që të bëjnë regjistrimin e këtij vendimi në të dhënat e pronës dhe tatimpaguesit të sistemit të tatimit në pronë. Në këtë situatë faktike fare nuk ka bazë pretendimi i paditësit për heshtje administrative nga Komuna e Prishtinës, për arsye se, në rastin konkret pala e interesuar rezulton ti ketë nxjerr dy akte administrative kur ka vendosur lidhur me ankesën e paditësit për faturën e tatimit në pronë me nr..., ashtu që herën e parë duke vepruar sipas aktgjykimit të gjykatës A.nr.1898/16 të datës 04.11.2019, në ri procedurë ka nxjerr vendimin me nr.1010-07-155461 të datës 10.02.2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit ka e lënë në fuqi njësinë e objektit me nr... me tatimpagues me nr... R.K, dhe herën e dytë duke vepruar në ri procedurë sërish tanë sipas vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me nr.44/2021 të datës 07.05.2021, ka nxjerr vendimin me nr.10-07-155461/1 të datës 10.06.2021, me të cilin e ka aprovuar ankesën paditësit si të bazuar. Paditësi ndaj këtij vendimi me të cilin në ri procedurë i është aprovuar ankesa si e bazuar nga shkresat e lëndës nuk rezulton që të ketë ushtruar ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve apo të ushtroj padi brenda 30 ditëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë sipas këshillës juridike të dhënë me këtë vendim, çka jep me kuptu se paditësi ka qenë i kënaqur me këtë vendim.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi tek me datë 31.08.2021 kishte paraqitur në gjykatë padi për konflikt administrativ të emërtuar njëkohësisht dhe alternativisht edhe kërkesë-parashtresë të veçantë për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues në bazë të nenit 68 të LKA, kundër Komunës së Prishtinës-Drejtorisë së Financave dhe MFPT-DTP, ndërsa me datë 15.10.2021 kishte ushtruar kërkesë të veçantë sipas nenit 68 të LKA-së, e të cilin parashtresë paditësi e kishte plotësuar më pastaj sipas aktvendimit të kësaj gjykate A.nr.1898/16 të datës 19.10.2021, me parashtresën e datë 29.10.2021, të dorëzuar në gjykatë, ku kishte precizuar parashtresën e datës 31.08.2021, duke deklaruar se e njëjta është padi për inicimin e konfliktit administrativ dhe se akti administrativ i godit me padi është vendimit i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me nr.99/2021 i datës 09.08.2021. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ka bazë pretendimi i paditësit për heshtje administrative nga pala e interesuar në këtë konflikt administrativ Komuna e Prishtinës dhe për miratim të aktit verbal apo aktit të miratuar në heshtje, sipas nenit 46 par.3 të LPPA, sepse siç u theksua më lartë, Komuna e Prishtinës lidhur me ankesën e paditësit ka nxjerr dy vendime, respektivisht vendimin me nr.1010-07-155461 të datës 10.02.2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit ka e lënë në fuqi njësinë e objektit me nr... me tatimpagues me nr... R.K, dhe herën e dytë duke vepruar në ri procedurë sipas vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me nr.44/2021 të datës 07.05.2021, ka nxjerr vendimin me nr.10-07-155461/1 të datës 10.06.2021, me të cilin e ka

aprovuar ankesën paditësit si të bazuar. Në këtë kontekst gjykata e shkallës së parë thekson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen aktit administrativ të miratuar në heshtje, siç ka pretenduar pala paditëse tek e paditura me plotësimin dhe precizimin e ankesës të datës 07.05.2021 dhe në kërkesën për rishikimin e ligjshmërisë së vendimit me nr.44/2021 të datës 07.05.2021 të MFPT-DTP, dhe në këtë konflikt administrativ, sepse në nenin 100 par.1 të LPPA është paraparë se “1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: “akti administrativ i miratuar në heshtje”). Mirëpo në vazhdim në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se “2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet kur parashihet ndryshe me ligj”. Në këtë kuptim gjykata thekson se në rastin konkret me dispozitën e nenit 31 par.8 të Ligjit Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005 është paraparë që “Nëse komuna nuk ka marrë vendim brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 6. të këtij neni, personi mund të ankohet drejtpërdrejt në Ministrinë e Financave”, çka do të thotë se Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme e ka rregulluar ndryshe situatën nga dispozitat e LPPA sa i përket situatës kur organi administrativ-Komuna nuk merr vendim brenda afatit ligjor, të caktuar me dispozitat e paragrafit 6 të nenit 31 Ligjit nr.06/L-005, prandaj edhe nuk gjen fare zbatim dispozita e nenit 100 par.1 të LPPA, ku parashihet akti administrativ i miratuar në heshtje.

Gjykata e shkallës së parë thekson se për mos nxjerrje të akti të ri administrativ në ri procedurë nga Komuna e Prishtinës sipas aktgjykimit A.nr.1898/16 të datës 04.11.2019, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpapia e paditësit, ishte anuluar vendimi me nr.10-07-155461 i datës 22.06.2016 i Bordit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave të Komunës së Prishtinës dhe lënda ishte kthyer në ri shqyrtim dhe ri vendosje, brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e dërgimit të aktgjykimit tek e paditura, siç ka pasur obligim Komuna e Prishtinës të veproj sipas aktgjykimit të gjykatës dhe nenit 65 të LKA-së, paditësi në përputhje me dispozitat e nenit 68 par.1 të LKA-së, pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh për nxjerrjen e vendimit, dhe pas kërkesës së palës për të nxjerr aktin administrativ brenda shtatë ditësh nga kjo kërkesë, ka mundur të kërkoj nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që e ka nxjerr aktgjykimin, mirëpo paditësi nuk ka vepruar sipas kësaj dispozite ligjore, por ka pritur nxjerrjen e vendimit me nr.1010-07-155461 të datës 10.02.2020 nga Komuna e Prishtinës e ndaj të cilit vendim ka ushtruar ankesë në MFPT-DTP me datë 07.04.2021, e për të cilin ankesë e paditura ka nxjerr vendimin me nr.44/2021 të datës 07.05.2021, me të cilin ka anuluar vendimin me nr.1010-07-155461 të datës 10.02.2020 të Komunës së Prishtinës dhe lëndën e ka kthyer në ri shqyrtim dhe rivendosje, e ku ky organ më pastaj në rivendosje ka nxjerr vendimin me nr.10-07-155461/1 të datës 10.06.2021, me të cilin e ka aprovuar ankesën paditësit si të bazuar. Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të gjitha provave në dosje të dokumentacionit shkresor, gjykata konstaton se vendimi me nr.99/22021 i datës 09.08.2021 i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është i drejt dhe i bazuar në dispozitat e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005 dhe Udhëzimin Administrativ MF nr.02/2019 për Procedurat Ankimore të Tatimit në Pronë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton

sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se paditësi prej Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal kishte kërkuar që gjykata të vendos vet për çështjen administrative duke e zëvendësuar aktin e paligjshëm administrativ të organit administrativ të shkallës së dytë dhe ky vendim i anuluar të zëvendësohet me aktgjykim, të detyrohet Komuna e Prishtinës që në përputhje me paragrafin 3 të nenit 46 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ta lëshoj vërtetimin me shkrim për palën e dëmtuar me përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar me heshtje me datën 23.12.2019, e më të cilin akt administrativ është pranuar në tërësi kërkesa-ankesa me fuqinë e ligjit-ex lege e paditësitatimpaguesit R.K e datës 22.06.2016, me nr.010-07-155461, si dhe pala paditëse të udhëzohet në procedurë kontestimore për realizimin e dëmit të shkaktuar nga ekzekutimi i akteve administrative të paligjshme të anuluar nga Komuna e Prishtinës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPPA-së, LKA-së, LPK-së, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 si dhe Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005 dhe Udhëzimin Administrativ MF nr.02/2019 për Procedurat Ankimore të Tatimit në Pronë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është marre me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, të pa argumentuara në prova konkrete dhe nuk kanë mbështetje ligjore për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Sepse, në rastin konkret, barra e të provuarit në procedurë si në këtë rast bie mbi paditësin i cili në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që do të dëshmonin të kundërtën e konstatimeve nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartcekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një

Numri i lëndës: 2021:245535
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05406507

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.588/2022, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi